



Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim
“Hidromorava” SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod i Kanalizaciju
“ Hidromorava” D.D
Regional Company for Water
“Hidromorava” J.S.C
Gjilan

Hidromorava KOMPANIA RAJONALE
Gjilan E UJËSJELLËSIT

HIDROMORAVA Sh.a.

No. 778 Data 03.07.2024

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-2012, nenit 8 të Rregullores mbi themelimin e mardhënies së punës në KRU “Hidromorava”-sha Gjilan, dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU “Hidromorava”-sha Gjilan shpall:

K O N K U R S P U B L I K

Për vendin e lirë të punës në KRU. Hidromorava Sh.A në : Gjilan , për këtë pozitë

1.1(Një): Inxhinier për Planifikim dhe Zhvillim

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – fakulteti i inxhinierisë ndërtimore – drejtimi hidroteknikë.

Përvoja e punës: Së paku dy /2/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: 1

Paga: 720.00 €

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë nën hetime apo të ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohja e programeve aplikative WaterCad, GIS (ESRI), AutoCad;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Punon në kalkulimin e çmimeve për paramasë dhe parallogaritë dhe përgatit dokumentet për projektet e ujësjellësit;
- Bashkëpunon edhe me shërbimet e tjera në KRU “Hidromorava” Sh.A.;
- Pas koordinimit të punëve në zyrë të planifikimit dhe punimit të projekteve sipas kërkesës së shërbimeve, obligohet të përcjellë edhe zhvillimin e punimeve në terren;
- Përgatit tërë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve dhe të njëjtin ia dërgon Shefit të Menaxhimit të Projekteve;
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me stafin inxhinierik në hartimin e projekteve investive në fushën e Hidroteknikës;
- Bënë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Shefit të Menaxhimit të Projekteve

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm si vijon:



Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim
“Hidromorava” SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod i Kanalizaciju
“ Hidromorava” D.D
Regional Company for Water
“Hidromorava” J.S.C
Gjilan

1. Dëshmi të kualifikimit shkollor, fotokopje e noterizuar;
2. Dokumentin e identifikimit;
3. CV – (të dhënat personale);
4. Çertifikatën se nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale.

Çertifikatën mjekësore (për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs në fund të procedurës rekrutuese e njejt/a do të kërkohet vetëm nga kandidati i pranuar në punë).

Aplikim bëhet online përmes këti e-mailit zyrtar puna@kru-hidromorava.com.

Konkurset publikohen në Web faqen zyrtare të kompanisë KRU Hidromorava
<https://kru-hidromorava.com/konkurse/>

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike të konkursit në mjetet e informimit publik , në linkun e shpalljeve publike të kompanisë puna@kru-hidromorava.com edhe atë nga data 03 Korrik 2024 deri më datë 18 Korrik 2024, në ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën që i plotesojnë kushtet e Konkursit ftohen për intervistë me shkrim dhe gojore dhe njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes postës elektronike dhe individualisht .



KRU." Hidromorava" Sh.A

PS: Këshillë për të gjith aplikuesit që të i përmbahen kushteve të parapara në Konkurs dhe të bashkangjesin dokumentacionin e kerkuar në Konkurs.